



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, u mbajtën seanca gjyqësore të martën dhe të mërkurën e kësaj jave. Të martën, dha dëshmi dëshmitari i 112-të i thirrur nga Prokuroria. Dëshmitari dëshmoi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes së lexuar në sallë të gjyqit, dëshmitari dhe një person tjetër u arrestuan nga UÇK-ja në korrik 1998 dhe më pas u mbajtën të ndaluar dhe u keqtrajtuuan në dy vende.

Të mërkurën, u mbajt seanca për ecurinë e çështjes për të diskutuar planifikimin dhe hapat e ardhshëm të procesit, duke pasur parasysh se po afrohet 15 prilli, data kur Prokuroria duhet të përfundojë paraqitjen e argumenteve të saj. Prokuroria njoftoi se ajo planifikon të thërrasë dy dëshmitarë në gjykatë javën e ardhshme dhe se nuk presin që dëshmitarë të tjerë të japin dëshmi pas 4 prillit. Palët diskutuan gjithashtu aspekte të tjera, si pranimin e provave dhe kërkesat e mundshme nga Mbrojtja në lidhje me rrëzimin e akuzave sipas rregullës 130.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 24 shkurt, në orën 09:00 paradite.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 13 shkurt, Trupi Gjykses vazhdoi paraburgimin e Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit, në vendime më vete për secilin. Megjithëse u konstatua se nuk ekziston rrezik i mjaftueshëm arratisjeje që të përlligjë mbajtjen e tyre në paraburgim, gjykatësit konstatuan se për të dy të akuzuarit ekziston rreziku se do të pengojnë ecurinë e procesit dhe do të kryejnë vepra penale të tjera kundër atyre që perceptohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarë që kanë dhënë ose

1





mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose pritët të paraqiten para gjykatës. Në të dy vendimet, Trupi Gjyqësor konstatoi gjithashtu se paraburgimi është proporcional dhe i arsyeshëm, sidomos duke pasur parasysh ecurinë e gjykimit.

Për informacion, katër të akuzuarit në këtë çështje gjyqësore u arrestuan në bazë të aktakuzës së konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pas shqyrtimit të provave mbështetëse, në një vendim të arsyetuar dhe publik. Ata mbahen në paraburgim, sepse për secilin të akuzuar gjykatësit vlerësuan se ekziston rreziku që të pengohet procesi dhe të kryhen vepra penale të tjera kundër dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore.

Në përputhje me të drejtën për gjykim të drejtë që garantohet nga e drejta ndërkombëtare dhe Kushtetuta e Kosovës, të akuzuarit prezumohen të pafajshëm, përveç nëse fajësia e tyre vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Ligji kërkon nga gjykatësit që për secilin të akuzuar të rishikojnë çdo dy muaj nëse paraburgimi i tyre vazhdon të përlligjet në bazë të standardit ligjor, nëse është i arsyeshëm dhe nëse ekzistojnë kushte alternative që mund të ulin rrezikun për dëshmitarët.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 14 shkurt, Trupi Gjyqësor miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar dëshmitë e 10 dëshmitarëve sipas rregullës 153. Kjo rregull lejon që dëshmia të pranohet me shkrim pa pasur nevojë që dëshmitari të paraqitet në sallë të gjyqit, në qoftë se dëshmia e dëshmitarit nuk lidhet konkretisht me veprimet dhe sjelljen kriminale të të akuzuarve.

Mbrojtja nuk kundërshtoi pranimin e shtatë dëshmimeve me shkrim me disa kushte, të cilat Prokuroria i pranoi. Në lidhje me tre dëshmitë e tjera me shkrim në kërkesë, gjykatësit hodhën poshtë një dëshmi, pranuan të dytën, dhe vendosën ta pranonin të tretën vetëm me disa kushte.

Më 18 shkurt, Trupi Gjyqësor hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit që gjykata të detyrojë Prokurorinë të thërrasë dy dëshmitarë për të cilët Prokuroria kishte





kërkuar t'i hiqte nga lista e dëshmitarëve të vet në shtator të vitit të kaluar. Gjykatësit rikujtuan se ata kishin ftuar Prokurorinë që të thjeshtonte paraqitjen e provave të saj dhe theksoi se Prokuroria ka thirrur tashmë disa dëshmitarë që kanë dëshmuar për të njëjtat fakte dhe rrethana për të cilat pritej të dëshmonin edhe dy dëshmitarët.

Në çështjen gjyqësore *Januzi dhe të tjerët*, më 18 shkurt, Trupi Gjykues, lëshoi një numër urdhrash në kuadër të një përpjekjeje për rishikimin e të gjitha parashtrimeve lidhur me marrëveshjet për pranimin e fajësisë, për të siguruar që sa më shumë informacion të bëhet publik, duke mbrojtur në të njëjtën kohë edhe dëshmitarët dhe viktimat. Gjykatësit theksuan se parimi i procesit publik përfshin jo vetëm seancat në sallë të gjyqit, por edhe parashtrimet e protokolluara dhe parashtrime të tjera në dosjen e çështjes gjyqësore.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, po ashtu më 18 shkurt, Kryetarja e DHSK-së caktoi gjykatësin Zhilber Biti si Gjykatës të Vetëm, që të vazhdojë mbikëqyrjen e zbatimit të urdhrat ndaj Salih Mustafës për zhdëmtim të viktimave, duke theksuar se caktimi paraprak i gjykatësit Biti për një vit është në përfundim dhe se urdhri ende nuk është zbatuar plotësisht.

Ndër të tjera, Gjykatësi i Vetëm do të marrë raporte nga Zyra Administrative në lidhje me ndonjë veprim të ndërmarë nga Programi për Kompensimin e Viktimave i Kosovës. Z. Mustafa u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe u urdhërua t'u paguajë zhdëmtime në shumën të ndryshme tetë viktimave pjesëmarrëse në proces, gjithsej 207.000 euro.

Pyetje nga gazetarët:

Duke u përgjigjur në pyetjen e një gazetares, zëdhënësi shpjegoi se për arsye të privatësisë, gjykata nuk mund të japë informacion për gjendjen shëndetësore të personave të paraburgosur dhe se ky është një detyrim ligjor për të mbrojtur të drejtat e të paraburgosurve. Sipas Rregullores së Paraburgimit të DHSK-së, nxjerrja e të dhënave mjekësore të të paraburgosurve është e mundur





vetëm me pëlqimin e tyre paraprak të bazuar në informacion, në përputhje me standardet e BE-së për mbrojtjen e të dhënave.

Zëdhënësi shtoi më tej se nuk ka qenë e pazakontë që të akuzuarit të mungojnë individualisht në seanca gjyqësore kur nuk ndihen mirë ose kanë ankesa të vogla në ditën kur mbahet seanca dhe se zoti Thaçi tani po merr pjesë në aktivitetet e rregullta ditore në objektin e paraburgimit.

